



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

I.AGJ.nr.1/24-62

PLANI I PUNËS

2025

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Degët: SUHAREKË & DRAGASH

Dhjetor 2024

Përmbajtja

- Fjala e Kryetares
- Përmbledhje

Organizimi i punës në Gjykatën Themelore në Prizren

- Funkcionet gjyqësore dhe udhëheqja e Departamenteve – Divizioneve
 - Departamenti për Krime të Rënda
 - Departamenti për të Mitur
 - Departamenti i Përgjithshëm
- Përcaktimi i numrit të gjyqtarëve & bashkëpunëtorëve brenda departamenteve dhe divizioneve, proporcional me numrin e lëndëve.
- Përcaktimi i objektivave dhe përgjegjësive të të punësuarve brenda administratës së gjykatës, për të siguruar efikasitet në punë.
- Përcaktimi i kalendarit vjetor të takimeve të rregullta me gjyqtarë, bashkëpunëtorë dhe staf administrativ.
- Krijimi i trupave brenda gjykatës për të siguruar skanim të hershëm të parashtruara në gjykatë

Administrimi i Gjykatës dhe përgjegjësitë

- Zbatimi i programit SMIL dhe SQEP
- Kalendari i mbajtjes së seancave efektive (bllok seanca) – evitimi i shtyrjes dhe anulimi të seancave dhe hartimi i raporteve për numrin e seancave të mbajtura, shtyra dhe anuluar
- Zbatimi i programit për audio dhe video incizim të seancave në sallat e gjykimit në fushën penale
- Transparenca dhe llogaridhënia (publikimi i vendimeve gjyqësore)
- Respektimi i afateve për dërgimin e lëndëve në gjykatë të shkallës së II-të
- Ekzekutimi në kohë i vendimeve gjyqësore së formës së prerë (përfshirë kundërvajtjen).
- Zbatimi i planit të trajnimeve nga bashkëpunëtorët dhe administrata.
- Vlerësimi i performancës së punës së bashkëpunëtorëve profesional dhe stafit administrativ
- Zbatimi i rekomandimeve të ZKA-së dhe adresimet e SKGJK-së, për menaxhimin e pasurisë, vlerësimin e performancës, inventarizim dhe asgjësimin e pasurisë

Zbatimi i strategjisë dhe Legjislacionit

- Zbatimi i planeve strategjike të KGJK-së, Efikasiteti dhe Prioritizimin i lëndëve brenda sistemit gjyqësor bazuar në Planin Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në

Drejtësi 2022-2025, Plani strategjik për trajtimin e lëndëve kundër korrupsionit, Plani strategjik për komunikim me media.

- Zbatimi i plotë i legjislacionit për respektimin e gjuhëve zyrtare
- Zbatimi i akteve të KGJK-së lidhur me organizimin e brendshëm dhe menaxhimin e gjykatës
- Plani për drejtësi procedurale në gjykata
- Ruajtja dhe arkivimi i lëndëve brenda gjykatës dhe dorëzimi i lëndëve të cilat i plotësojnë kushtet për Agjencinë shtetërore të arkivave
- Zbatimi i rekomandimeve që dalin nga raportet inspektuese të përgatitura nga NJIGJ të cilët monitorojnë punën e gjykatës
- Zbatimi i rekomandimeve që dalin nga raportet e përgatitura nga monitorimet e realizuara nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore.
- Zbatimi i udhëzuesit për referimin e rasteve në procedurë të ndërmjetësimit
- Zbatimi i Udhëzuesit për politikën ndëshkimore

Monitorimi dhe Raportimi

- Hartimi i planit për monitorimin e punës së gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve dhe administratës nga ana e Kryetarit të Gjykatës
- Hartimi i raporteve dhe rezultatet që dalin nga monitorimi i organizatave vendore dhe ndërkombëtare
- Hartimi i raporteve për numrin e seancave të mbajtura, të seancave të shtyra dhe seancave të dështuara
- Hartimi i raporteve periodike dhe vjetore të punës së Kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarëve mbikëqyrës të degëve për KGJK-në

Prioritetet e Departamenteve të gjykatës dhe rekomandimet për vitin 2025

Departamenti për Krime të Rënda (DKR)

Departamenti për të Mitur (DM)

Departamenti Përgjithshëm/Divizioni Penal (DP)

Divizioni Civil (DC)

Divizioni për Kundërvajtje

- Përfundimi

Fjala e Kryetares

Kam nderin dhe kënaqësinë të prezantoj Planin e punës për vitin 2025 të Gjykatës Themelore në Prizren së bashku me degët e saj Suharekë & Dragash.

Ky plani i punës së gjykatës është hartuar në bashkëpunim me gjyqtarët dhe administratën e gjykatës, e që i mundësuan gjykatës të tejkalojë me sukses sfidat me të cilat po ballafaqohemi si gjykatë dhe t'i përmbahemi me devotshmëri misionit për zbatimin dhe mbrojtjen e sundimit të ligjit e nëpërmes saj të mbrojmë edhe të drejtat dhe liritë e njeriut.

Ne kemi një mision të përbashkët që Gjykata Themelore e Prizrenit të funksionojë si gjykatë e pavarur, e paanshme, e besueshme, profesionale, efikase, e përgjegjshme, llogaridhënëse si dhe transparente.

Plani i punës 2025 paraqet një mundësi shtesë për t'i dhënë drejtim të ri zhvillimit të gjykatës tonë, duke shpalosur ide të reja në përputhje me kërkesat e kohës dhe me rrethanat e reja në punë dhe duke reflektuar mbi sfidat e përballura gjatë vitit paraprak.

Në planin e ri janë përcaktuar prioritetet për vitin e ardhshëm në punën e gjykatës siç janë rritja e efikasitetit, unifikim i praktikave brenda gjykatës dhe degëve të saj, standardizim në dhënie të shërbimeve dhe procedim i secilës kërkesë sipas një plani kohor duke respektuar renditjen sipas pranimit dhe sipas ligjit, puna bazuar në ndershmëri dhe integritet duke kërkuar dhe nxitur gjyqtarët dhe punonjësit tjerë të gjykatës që të synojnë standarde të larta të etikës në sjellje dhe në veprimet e tyre. Përgjegjshmëri e lartë në ushtrimin e funksioneve, profesionalizëm, reduktim i numrit të lëndëve të vjetra, shfrytëzim i burimeve njerëzore aktuale me kapacitet të plotë për rritjen e efikasitetit, rritje e nivelit të sigurisë brenda objektit të gjykatës dhe krijimin e kushteve të mira dhe qasje profesionale për çdo person në kuadër të zbatimit të së drejtës.

Pa angazhimin e të gjithëve, do të kemi të pamundshëm të arrijmë aty ku synojmë, andaj pres që viti 2025 të jetë vazhdimësi e efikasitetit dhe ofrimit të shërbimeve kualitative për qytetarët dhe palët që marrin shërbime në gjykatë.

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prizren

Shpresa Emra

P Ë R M B L E D H J E

Bazuar në nenin 14 pika 2.3 të Ligjit për Gjykatat (Ligji 06/L-054) dhe Rregullores Nr.02/2020 Për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren, pas marrjes së propozimeve në mbledhjen e kolegjiut të gjyqtarëve të kësaj gjykate, përcakton Planin e Punës dhe Programin për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve, të gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Themelore në Prizren për vitin 2025.

Ky plan i punës është strukturuar në atë mënyrë që të avancoj aktivitetet dhe rezultatet me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të punës së Gjykatës Themelore në Prizren si dhe degëve të saj, si në aspektin e organizimit profesional ashtu edhe në atë administrativ-teknik, realizimi i të cilave do të bëhet përmes aktiviteteve të arritshme brenda periudhës një vjeçare.

Ky plan program paraqet tërësinë e aktiviteteve që do të zbatohen në vitin 2025, ndër të tjera përcakton këto objektiva :

- Organizimin e punës në Gjykatën Themelore në Prizren si dhe degëve të saj,
- Organizimin e punës së administratës gjyqësore
- Administrimi i Gjykatës dhe përgjegjësitë
- Zbatimi i strategjisë dhe Legjislacionit
- Monitorimi dhe Raportimi
- Prioritetet e Departamenteve të gjykatës dhe
- Rekomandimet për vitin 2025

Në kuadër të këtyre objektivave janë përfshirë të gjitha segmentet e organizimit, menaxhimit , planifikimit, zbatimit të planeve të KGJK-së llogaridhënies dhe monitorimit për të gjithë të punësuarit në gjykatë. Gjithashtu janë përcaktuar edhe prioritetet për vitin 2025.

Organizimi i punës në Gjykatën Themelore në Prizren

-Me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Themelore në Prizren, udhëheqë Kryetarja e gjykatës. Në mungesë të Kryetares me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës udhëheq nënkryetarja e gjykatës, për organizimin e punës së degëve të gjykatës në Suharekë dhe Dragash, udhëheqin gjyqtarët mbikëqyrës.

-Me menaxhimin e punëve administrative, teknike dhe sigurimit të objekteve, do të administroj U.D. Administratorja e Gjykatës Themelore në Prizren. Për degën e gjykatës ndihmës administratorë.

Funksionet gjyqësore dhe udhëheqja e Departamenteve – Divizioneve

Për kryerjen e funksioneve gjyqësore të Gjykatës Themelore në Prizren, janë të organizuara 3 (tre) Departamente:

- Departamenti për Krime të Rënda;
- Departamenti për të Mitur;
- Departamenti i Përgjithshëm, në kuadër të së cilit funksionojnë këto Divizione:
 - Divizioni Penal;
 - Divizioni Civil dhe
 - Divizioni për Kundërvajtje.

Me qëllim të organizimit më të mirë të punës si dhe zgjidhjen efikase të lëndëve, në kuadër të çdo Departamenti është i caktuar një gjyqtar si Udhëheqës i Departamentit. Ndërsa në krye të çdo divizioni, caktohet një gjyqtar përgjegjës që do të organizoj dhe menaxhoj punën e atij divizioni.

Udhëheqësit e Departamenteve dhe përgjegjësit e Divizionit, do t'i raportojnë Kryetares së gjykatës për punën e Departamenteve - Divizioneve, së paku njëherë në muaj. Pjesë e raporteve të udhëheqësit të departamentit dhe përgjegjësit të divizionit, duhet të jenë edhe raportet e gjyqtarëve përgjegjës të divizioneve.

Kryetarja e Gjykatës, mund të kërkoj nga udhëheqësit e departamenteve ose gjyqtarëve përgjegjës të divizioneve, që të paraqesin raporte mujore, ose raporte për ecurinë e lëndëve të veçanta.

Gjykata Themelore e Prizrenit së bashku me degë ka gjithsej 33 (tridhjetë e tre) gjyqtar/e, Kryetarja e gjykatës dhe 26 (njëzetë e gjashtë) gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, ndërsa 7 (shtatë) gjyqtar në dy degë të gjykatës.

Në fillim të vitit 2025 janë edhe 3 (tre) gjyqtarë në fazën e trajnimit fillestar, të cilët gjatë vitit në dy faza do të fillojnë punën dhe angazhimin në gjykatës

Departamenti për Krime të Rënda

Në Departamentin për Krime të Rënda, do të punojnë 4 (katër) gjyqtarë:

1. Raima Elezi (Nënkryetare e gjykatës)
2. Ajser Skenderi (Udhëheqëse e DKR-së)
3. Teuta Krusha

4. Artan Sejrani

Gjatë vitit 2025, gjyqtarja Raima Elezi arrin moshën e pensionimit, andaj në këtë Departament me kërkesë të Kryetares do të ndryshohet plani i punës dhe gjyqtarja Sadije Selmani do të avancohet nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda me 1 shkurt 2025 me miratimin e KGJK-së. Me caktimin e gjyqtares Sadije Selmani në Departamentin për Krime të Rënda nga data 01 shkurt 2025, me vendim të veçantë të gjithë gjyqtarët e Krimeve të Rënda do të pranojnë me nga 100 lëndë të Departamentit të Përgjithshëm të gjyqtares Sadije Selmani, e njëjta do të mban lëndët të cilat i ka filluar dhe i ka në punë, kurse të tjerat do të ndahen në mënyrë proporcionale tek tre gjyqtarë të tjerë. Për shkaqet se pse këto lëndë i caktohen gjyqtarëve të Departamentit të Krimeve të Rënda do të jepen sqarime plotësuese me vendim të veçantë gjatë ri caktimit .

Gjithashtu, Kryetarja e gjykatës, njëherit si gjyqtare e Departamentit për Krime të Rënda do të merr pjesë në trupe gjykuese nga data 1 shkurt 2025 si dhe do të pranojë lëndët e procedurës paraprake të Departamentit për Krime të Rënda si gjyqtarë tjerë të këtij departamenti.

Gjyqtarja e Departamentit për të Mitur Arjeta Gashi me aktvendim të veçantë do të caktohet si gjyqtare e cila do të merr pjesë në trup gjykues në Departamentin për Krime të Rënda duke pasur parasysh se nga muaji i shkurt 2025 do të filloj të zbatohet neni 25 paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale i cili përcakton se gjykimet në Departamentin për Krime të Rënda duhet të gjykohen vetëm nga ana e gjyqtarëve të këtij departamenti.

Në këtë drejtim, pas tremujorit të dytë të viti 2025 do të kemi një transferim të gjyqtarit Ilir Rashkaj nga Departamenti për Krime të Rënda nga Gjykata Themelore në Gjakovë, në Gjykatën Themelore në Prizren në Departamentin për Krime të Rënda.

Departamenti për të Mitur

Në Departamentin për të Mitur do të punoj 1 (një) gjyqtare:

1. Arjeta Gashi

Lëndët në procedurë përgatitore në këtë Departament do ti trajtojnë gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda.

Departamenti i Përgjithshëm

Në Departamentin e Përgjithshëm, Divizioni Penal do të punojnë 6 (gjashtë) gjyqtarë:

1. Sadije Selmani (Mbikëqyrëse e Divizionit Penal - deri më 01 shkurt 2025)
2. Vjollca Buzhala
3. Fatmir Krasniqi (Mbikëqyrës i degës në Dragash)

4. Sami Gashi
5. Lulzim Hoxha
6. Diora Bajrami

Gjyqtari Sami Gashi caktohet si Mbikëqyrës i Divizionit Penal nga data 01 shkurt 2025.

Në Departamentin e Përgjithshëm, Divizioni Civil do të punojnë njëmbëdhjetë (11) gjyqtarë:

1. Edije Sezairi (Udhëheqëse e Departamentit të Përgjithshëm - deri me 01 shkurt 2025)
2. Shaban Shala
3. Atdhe Berisha
4. Gëzim Shehu (Mbikëqyrës i Divizionit Civil – nga data 01 shkurt 2025)
5. Shyqri Hoxha
6. Taulant Rexhëbeqaj
7. Baki Shigjeqi
8. Njomëza Berisha
9. Uran Zogaj
10. Agron Karatash
11. Hilmi Elshani (Trajnimi fillestar AD)

Gjyqtarja Edija Sezairi në ndërkohë është avancuar në Gjykatën e Apelit dhe do të fillojë punën në këtë gjykatë me 01 shkurt 2025, andaj si Udhëheqës i Departamentit të Përgjithshëm caktohet gjyqtari Shaban Shala, kurse Mbikëqyrës i Divizionit Civil caktohet gjyqtari Gëzim Shehu.

Në Departamentin e Përgjithshëm, Divizioni Kundërvajtjes do të punojnë tre (3) gjyqtarë:

1. Luan Berisha
2. Alija Fazliji
3. Nazim Vllaqo

Gjithashtu tre gjyqtarë që janë në trajnimin fillestar në Akademinë e Drejtësisë, (Leutrim Krasniqi, Lavdim Makshana dhe Senat Elshani), do të caktohen në departamente në momentin kur të përfundojnë trajnimin fillestar, ne ndryshimin e planit të punës të propozuar nga Kryetarja e gjykatës dhe miratuar nga KGJK-ja.

Gjyqtarja Njomza Berisha nga muaji janar 2025 është në pushim të lehonisë dhe lëndët e saja do të ri caktohen te gjyqtarët nga divizioni civil në mënyrë proporcionale, gjithashtu edhe lëndët e gjyqtarës Edije Sezairi do të ri caktohen në mënyrë proporcionale në të gjithë gjyqtarët e divizionit civil. Një gjyqtar nga divizioni civil do të caktohet si gjyqtar i vetëm për trajtim të lëndëve të cilat kanë të bëjnë me Dhunën në familje me datë 01 shkurt 2025 me vendim të veçantë pas konsultimeve dhe mbledhjes që do të mbahet me gjyqtarët e këtij divizioni

Gjyqtarët gjatë vitit kalendarik 2025, mund të caktohen dhe ri-caktohen në departamente dhe divizione tjera ndryshe nga sistematizimi i këtij plani, varësisht nga nevojat e gjykatës për të adresuar ngarkesën me lëndë, për të zvogëluar vonesat në kategoritë e caktuara të lëndëve dhe ngritur efikasitetin e gjykatës në përgjithësi.

Degët e gjykatës

Degët e Gjykatës Themelore në Prizren janë: Dega në Suharekë dhe Dega në Dragash.

Në degët e gjykatës, sipas Ligjit për Gjykata, funksionojnë Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal dhe Divizioni Civil dhe trajtohen lëndët e Divizionit të Kundërvajtjes, ndërsa secila degë e gjykatës, ka edhe gjyqtarin mbikëqyrës dhe ndihmës administratorin, të cilët do të kujdesen për organizmin dhe mbarëvajtjen e punës brenda gjykatës.

Në degën e gjykatës në Suharekë (në fillim të vitit 2025) janë të angazhuar 6 (gjashtë) gjyqtarë:

1. Selajdin Gallapeni (Divizioni Civil) – Mbikëqyrës i Gjykatës Themelore Prizren – Dega Suharekë
2. Qemail Suka (Divizioni Penal)
3. Lavdim Bajraktari (Divizioni Penal)
4. Robert Tunaj (Divizioni Civil)
5. Adem Krasniqi (Divizioni Civil)
6. Shqipron Sedolli (Divizioni Civil)

Në degën e Gjykatës në Dragash, (në fillim të vitit 2025) do të jenë të angazhuar 3 (tre) gjyqtarë:

1. Fatmir Krasniqi – Mbikëqyrës i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega Dragash (Divizioni Penal)
2. Sabaheta Kurteshi – Divizioni Civil & Divizioni Penal
3. Alija Fazliji – Divizioni i Kundërvajtjes

Bashkëpunëtorët Profesional

Në Gjykatën Themelore në Prizren, në fillim të vitit 2025, janë të angazhuar 17 (shtatëmbëdhjetë) bashkëpunëtorë profesional, 5 (pesë) në degën e gjykatës në Suharekë dhe dy (2) në degën e gjykatës në Dragash.

Bashkëpunëtorët profesional janë të caktuar të punojnë në Departamente dhe Divizione me gjyqtarë të caktuar dhe sipas nevojës angazhohen edhe me punë shtesë të tjera.

Bashkëpunëtorët profesional do të ri-caktohen në departament dhe divizione sipas ngarkesës me lëndës dhe proporcionalisht me numrin e lëndëve aktive. Duke pasur

parasysh se në Divizionin Civil kemi rreth 14700 lëndë, ndërsa në DKR dhe Divizionin Penal janë rreth 2800 lëndë, gjatë vitit 2025 në Divizionin Civil do të jenë të angazhuara 10 (dhjetë) bashkëpunëtorë, ndërsa në lëmine penale 7 (shtatë) bashkëpunëtorë. Një prej bashkëpunëtorëve aktual është zgjedhur prokuror dhe ka dhënë dorëheqje pasi që është dekretuar nga ana e Presidentes, 2 (dy) bashkëpunëtorë të tjera janë në pushim të lehonisë dhe nuk pritet të kthehen deri në gjysmën e dytë të vitit 2025. Po ashtu, 8 (tetë) prej bashkëpunëtorëve profesional janë në proces të rekrutimit për gjyqtarë, të cilët kanë arritur në fazën e intervistës. Pas përfundimit të këtij procesi, varësisht prej rezultatit dhe nevojës së departamenteve do të bëhet riorganizimi i bashkëpunëtorëve. Gjithashtu, pritet transferimi i 2 (dy) bashkëpunëtorëve prej degës së gjykatës në Suharekë, pasi të plotësohen vendet e tyre me bashkëpunëtorë të ri.

Përcaktimi i objektivave dhe përgjegjësive të të punësuarve brenda administratës të gjykatës, për të siguruar efikasitet në punë

Stafi Administrativ punën e tij do të bazojë në rregulloren nr.05/2024 për orarin e punës dhe pushimet në administratën e sistemit gjyqësor.

Në takimet e rregullta me udhëheqësit e zyrave dhe administratën do të vlerësohet respektimi i kësaj rregullore dhe rregulloreve të tjera në administratë që janë në fuqi.

Administratori/ja i gjykatës do të kujdeset për zbatimin e Rregullores nr.03/2024, për procedurën disiplinore për nëpunësit në administratën e sistemit gjyqësor.

Të gjithë nëpunësit janë të obliguar të respektojnë Kodin e Mirësjellje për personelin e administratës gjyqësore dhe Kodin e Etikës Profesionale.

Secili zyrtar i punësuar në administratën e gjykatës (shërbyes civil dhe jo civil), do të angazhohet në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive që ka sipas organogramit për përshkrimin e detyrave të punës.

Për çdo aktivitet/punë shtesë, apo ri-caktim në një detyrë tjetër, do të përpilohet vendim i veçantë, që do të përshkruan saktë detyrat që duhet kryer dhe kohën e fillimit dhe mbarimit të angazhimit.

Përcaktimi i kalendarit vjetor të takimeve të rregullta me gjyqtarët, bashkëpunëtorët profesional dhe stafin administrativ.

Kryetarja e gjykatës, çdo 3 (tre) muaj (para raportimit në KGJK), do të mban kolegjiomet e rregullta me të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Themelore Prizren dhe të degëve, të cilat do të mbahen me në premtën e parë pas përfundimit të tremujorit, e të cilat janë me këto data 07.03.2025, 04.07.2025, 03.10.2025 dhe 09.01.2026. Ndërsa takimet me bashkëpunëtorë profesional do të mbahen një javë pas kolegjiomeve të rregullta me gjyqtarë.

Sipas nevojës një herë në muaj, Kryetarja mban takime me gjyqtarët udhëheqës të Departamenteve dhe Divizioneve.

Kryetarja e gjykatës, me administratoren e gjykatës do të mbaj takime të rregullta ditore dhe javore dhe çdo 1 (një) muaj do të mban takimet të rregullta me Udhëheqësit e zyrave të gjykatës dhe me mbikëqyrësit e zyrave për menaxhimin e lëndëve.

Kryetarja e gjykatës, Administratorja e gjykatës dhe Udhëheqësit e Zyrave, 2 (dy) herë në vit do të mban takim me të gjithë stadin administrativ.

Krijimi i trupave brenda gjykatës dhe Degës për të siguruar skanimin e hershëm të parashtrësive të pranuar në gjykatë në lëmi civile

Në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil janë formuar trupe punuese nga ana e bashkëpunëtorëve profesional të cilët sigurojnë skanimin e hershëm të parashtrësive të pranuar në gjykatë. Në këtë grup punues punojnë të gjithë bashkëpunëtorët si dhe në gjatë punës jashtë orarit të punës punon edhe nga një gjyqtar i lëmisë civile i cili organizon dhe përcjellë ecurinë e punës. Ky organizim ka dhënë rezultate të mira të punës dhe do të vazhdojë edhe në vitin 2025 deri sa të stabilizohet gjendja e pranimit të lëndëve në numër të madh në lëmi civile. Duke pasur parasysh se 9 bashkëpunëtor nga gjykata jonë janë në proces të emërimit për gjyqtar ky plan i organizimit mund të pësojë ndryshime të cilat do të modifikohen dhe do të ndryshojnë sipas gjendjes së ndryshuar.

Administrimi i gjykatës dhe përgjegjësitë

Zbatimi i programit SMIL dhe SQEP

Gjykata Themelore në Prizren së bashku me degë do të vazhdoj me zbatimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (/SMIL), i cili ka treguar sukses dhe rritjen e efikasitetit dhe transparencës së gjykatës. Edhe në vitin 2025 raportet e të gjithë gjyqtarëve, do të nxjerrën vetëm përmes sistemit SMIL, përfshirë këtu edhe raportet e përgjithshme të gjykatës, të gjitha aktakuzat e prokurorisë së shtetit do të pranohen përmes SMIL, po ashtu orari i seancave gjyqësore për publikim në ueb faqen e gjyqësorit do të jetë i lidhur direkt me SMIL. Synimi jonë për vitin 2025 do të jetë përputhja e plotë e dosjes fizike me dosjen elektronike 100%.

Gjithashtu, edhe programi SQEP, gjatë vitit do të jetë në zbatim 100%. Dy zyrtarë – referentë do të jenë përgjegjës, që aktgjykimet e plotfuqishme, ditën (apo një ditë pas), datës së plotfuqishmërisë, të vendosen të dhënat në sistemin SQEP, përfshirë të dhënat gjenerale dhe vendimin gjyqësor, dënimet kryesore, dënimet alternative, dënimet plotësuese dhe dënime tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Kalendari i mbajtjes së seancave efektive – evitimi i shtyrjes dhe anulimit të seancave (Hartimi i raporteve për numrin e seancave të mbajtura, shtyera dhe anuluar).

Gjykata Themelore në Prizren dhe degët, gjatë vitit 2024, kanë pasur një përqindje prej rreth 10-15 % të dështimit apo anulimit të seancave gjyqësore.

Edhe gjatë vitit 2025, synohet që kjo përqindje të jetë edhe më e ulët, sidomos dështimi i seancave të mos jetë si faktor i gjykatës.

Në kolegjiunet e gjykatës do të diskutohet me gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda, caktimi i seancave të njëpasnjëshme (bllok seanca) me qëllim të efikasitetit, sidomos tek lëndët që janë pjesë e Planeve Strategjike të KGJK-së.

Gjithashtu, nga Gjyqtarët do të kërkojmë raporte për shtyrjen e seancave gjyqësore, arsyen e shtyrjes apo anulimit të seancave gjyqësore, në mënyrë që të evitojmë seancat jo produktive.

Gjykata Themelore në Prizren, objekti ku funksionin Divizioni Civil ka 2 (dy) salla të gjykimit, të cilat menaxhohen nga Mbikëqyrësi i Divizionit.

Objekti i gjykatës ku funksionin Departamenti për Krime të Rënda, të Mitur dhe Divizioni Penal ka 4 (katër) salla të gjykimit dhe është caktuar 1 (një) zyrtar përgjegjës (Operatori i IT-së), i cili menaxhon me orarin e seancave gjyqësore, në mënyrë që të mos ketë dështim të seancave.

Zbatimi i programit për audio dhe video incizim të seancave në sallat e gjykimit në fushën penale

Gjykata Themelore Prizren, (objekti i vjetër) ka 4 (katër) salla të Gjykimit, nga të cilat të gjitha janë të pajisura me sistemin e audio incizimit, 1 (një) sallë është e pajisur me video dhe audio incizim. Të gjitha salla janë funksionale 100% dhe të gjitha gjykimet që mbahen nga ana e DKR janë duke u mbajtur me sistem të audio incizimit.

Në takimet e kolegjiuneve dhe në takimet me stafin administrativ, do të kërkohet të zbatohet në tërësi sistemi i audio incizimit në sallat ku mbahen gjykimet të lëmisë penale (aty ku janë funksionale këto sisteme) ashtu që edhe nga gjyqtarë, por edhe nga zyrtarë ligjor dhe sekretarë juridike do të kërkojnë raporte mujore, se a përputhen seancat e mbajtura në sallat e gjykimit me shfrytëzimin e pajisjeve audio incizimit.

Zyrtari përgjegjës (Operatori i IT-së), do të kujdeset që në secilën seancë të caktuar në sallë të gjykimit, sistemi të jetë funksional dhe i shfrytëzueshëm.

Transparenca dhe llogaridhënia

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, gjykata do të informojë publikun rregullisht mbi punën dhe aktivitetet e gjykatës. Publiku në baza ditore do të kenë qasje në orarin e seancave gjyqësore të çështjeve penale, civile apo të kundërvajtjes i cili do të publikohet në ueb faqen e gjykatës dhe që gjatë vitit 2025 do të jetë funksional 100%.

Po ashtu, publiku do të ketë qasje në statistikën e gjykatës, raportet e punës, statistikën e performancës së gjykatës, planin dhe programin vjetor të punës do të jenë të qasshme për të gjithë, me çka publikut do t'i mundësohet qasje e gjerë në aktivitetet e gjykatës, për të cilat publiku njëkohësisht do të mund të informohet edhe përmes rrjeteve sociale që shfrytëzon gjykata

Gjykata publikon të gjitha vendimet gjyqësore që janë për publikim, konform udhëzimeve administrative në fuqi.

Si Kryetare e gjykatës, një herë në muaj, organizoj "Ditën e Hapur", ashtu që presim në takim dhe bashkëbisedim të gjithë qytetarët dhe palët që kanë shfaqur interesim për takim me Kryetaren. Në këto takime mbahet një procesverbal i veçantë dhe për secilën ankesë përpilohet shkresë e veçantë drejtuar gjyqtarit apo stafit administrativ (varësisht nga kërkesa e palëve).

Gjithashtu sipas kërkesës, gjykata pret në vizitë grupe të ndryshme studentësh, nxënësit dhe grupe të tjera, për të cilat prezantohet puna e gjykatës.

Gjykata në vitin 2025 do të ketë dy (2) grupe të praktikantëve, të cilat vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit me Fakultetet Juridike.

Për vitin 2025, Gjykata Themelore në Prizren ka përpiluar edhe Planin e veprimit për komunikim, që parasheh veprime konkrete me data të para caktuara.

Respektimi i afateve për dërgimin e lëndëve në gjykatën e shkallës së II-të dhe III-të.

Gjatë vitit 2025, Udhëheqësja e Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve në bashkëpunim me mbikëqyrësit e sektorëve, do të përcjellin dërgimin/përcjelljen e lëndëve me ankesë apo me mjete të tjera juridike, në gjykatën e shkallës më të lartë.

Respektimi i afateve ligjore, përgatitja e lëndës në mënyrë elektronike dhe fizike, do të evidentohet edhe përmes libër regjistrave fizik që do të pranohen në janar të vitit 2025.

Ekzekutimi me kohë i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, përfshirë edhe vendimet gjyqësore nga lëmia e kundërvajtjes.

Në fillim të vitit 2025 gjykata ka të pa plotësuar Mbikëqyrësin e Sektori për Ekzekutim dhe Arkivim dhe Statistika dhe planifikohet që në fillim të vitit 2025 të plotësohet ky vend i punës.

Zyra për menaxhimin e lëndëve referentët e kësaj zyre, pas arritjes së plotfuqishmërisë së vendimit, do të përpilojnë urdhëresa për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, që përfshin dënime kryesore, alternative, plotësuese dhe ekzekutimet e gjobave dhe shpenzimeve procedurale.

Zyra për ekzekutimin e sanksioneve penale, do të ketë të angazhuar 1 (një) referent, i cili përkujdeset për aspektin procedural, kurse Zyra e Kryetares së Gjykatës do të ketë nën mbikëqyrje të drejtpërdrejt procesin e ekzekutimit të sanksioneve penale.

Zbatimi i planit të trajnimeve nga bashkëpunëtorët dhe administrata

Me qëllim të organizimi dhe planifikimit të trajnimeve, të gjithë bashkëpunëtorëve profesional dhe stafit administrativ i është dërguar formulari për plotësim, ku secili duhet të specifikojë nevojat dhe fushën që ka nevojë për trajnim plotësues. Gjatë vitit 2024 një pjesë e bashkëpunëtorëve profesional kanë përfunduar trajnimet të cilat janë planifikuar nga ana e Akademisë së Drejtësisë dhe pjesa tjetër do të vazhdojnë dhe do të përfundojnë trajnimin gjatë vitit 2025.

Përmes Zyrtares së personelit dhe Administratores, do të mbahen regjistra për pjesëmarrjen e bashkëpunëtorëve dhe stafit administrativ në trajnimet që organizon KGJK-ja përmes Akademisë së Drejtësisë.

Vlerësimi i performancës së punës së bashkëpunëtorëve profesional dhe stafit administrativ.

Gjatë vitit 2025, Bashkëpunëtorët Profesional çdo muaj do të dërgojnë raportet e punës tek zyrtarja e caktuar nga Kryetarja e Gjykatës. Zyrtarja përgjegjëse pas verifikimit dhe kalkulimit, çdo tre (3) muaj i përcjell Zyrës së Kryetares raportet për normën e punës së bashkëpunëtorëve.

Këto raporte, do të diskutohen në kolegjiunet e rregullta çdo tre (3) muaj me bashkëpunëtorët profesional. Gjithashtu në TM4, bashkëpunëtorët në fund vit do të vlerësohen edhe për punën e përgjithshme një (1) vjeçare.

Në fund të TM4, nga Administratori/ja dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejt, stafi administrativ do të vlerësohet konform Rregullores 10/2024 për vlerësimin e rezultatit në punë për nëpunësit në administratën e sistemi gjyqësor.

Zbatimi i rekomandimeve të ZKA-së dhe adresimet e SKGJK-së, për menaxhimin e pasurisë, vlerësimin e performancës, inventarizimin dhe asgjësimin e pasurisë.

Gjatë vitit 2024, Gjykata nuk ka pasur auditim zë ZKA-së, apo SKGJK-së, për pasurinë jo financiare të Gjykatës, andaj për vitin 2025 nuk kemi rekomandime të specifikuar.

Gjykata në fillim të vitit 2025, konform Rregullores nr. 09/2023 për Menaxhimin Ruajtjen dhe Tjetërsimin e Pasurisë Jo Financiare në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe në Gjykata, në muajin Janar, me vendim do të formon tre (3) Komisione (të përbërë nga zyrtarë të Gjykatës), të cilët gjatë vitit do të përkujdesen për mbarëvajtjen e procedurave,

siç janë evidentimi i pasurisë, inventarizimi dhe regjistrimi, vlerësimi dhe asgjësimi i pasurisë jo financiare.

Në muajin e fundit të vitit 2025, secili Komision do të paraqet raportin e punës Administrative dhe Kryetares së Gjykatës. Raportet do të përmbajnë kohën e kryerjes së aktiviteteve dhe detyrave.

Zbatimi i strategjisë dhe Legjislacionit

Zbatimi i planeve Strategjike të KGJK-së

Kryetarja e gjykatës do të sigurojë mbikëqyrje të përditshme gjyqësore dhe menaxheriale në zbatimin e planeve Strategjike të KGJK-së dhe atë të :

- Planit Strategjik për Efikasitetin dhe prioritetin e lëndëve brenda sistemit gjyqësor, bazuar në Planin Strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2023-2025,
- Planit strategjik për trajtimin e lëndëve kundër korrupsionit,
- Planit strategjik për Komunikim me media dhe publikun.

Qëllimi i këtyre planeve strategjike është paraqitja e një vizioni të përgjithshëm strategjik për adresimin dhe zgjidhjen e lëndëve të cilat janë me prioritet, përfshirë lëndët që janë kthyer në rigjykim, lëndët të cilat janë të prioritetit të lartë në bazë të ligjeve përkatëse, lëndët të cilat janë punuar në gjykata dhe ka kaluar dy (2) vite për të cilat nuk ka filluar trajtimi i tyre, si dhe lëndët e tjera për të cilat duhet ndërmarrë veprime të përsheptuara.

Sipas kërkesave të këtyre planeve strategjike, Kryetarja e gjykatës do të mbledh informata nga gjyqtarët që trajtojnë këto raste dhe në baza mujore do të raportoj lidhur me statusin e lëndëve të Kryetari i Komisionit për Vlerësimin dhe Raportimin e këtij plani.

Plani strategjik për efikasitetin dhe prioritetin e lëndëve brenda sistemit të gjykatës 2022-2025, është prioritet dhe udhëzimi kryesor për punën profesionale të Gjykatës Themelore në Prizren gjatë vitit 2025.

Përveç aktiviteteve dhe planifikimeve të paraqitura në këtë plan, Gjykata Themelore në Prizren dhe degët Suharekë & Dragash, do të kryejnë veprime dhe aktivitete tjera të nevojshme në baza ditore dhe mujore, me qëllim efikasiteti dhe ofrimit të shërbimeve kualitative për qytetarët dhe palët.

Andaj referuar kësaj, pas riorganizimit në vitin 2023 dhe 2024, Gjykata Themelore në Prizren, gjatë vitit 2025 synim kryesor ka zgjidhjen e lëndëve në afat sa më të shkurtër kohor, sidomos në Divizionin Civil, dhe trajtimin me shumë kujdes të rasteve me interes publik në Departamentin për Krime të Rënda, në përputhje me parimet e drejtësisë.

Për të realizuar këtë planifikojmë mbikëqyrjen e përditshme gjyqësore dhe menaxheriale për zbatimin e këtij plani, përpilimin e raporteve të rregullta mujore dhe tre mujore, për

trajtimin e rasteve specifike të ndikojnë drejtpërdrejt në perceptimin e publikut, me qëllim të rritjes së besueshmërisë në gjykatë.

Që nga aprovimi i Planit Strategjik 2023 si Kryetare e gjykatës, kam zhvilluar takime të veçanta, me udhëheqësit e Divizioneve, me gjyqtarë të secilit Departament dhe të gjithë gjyqtarëve i'u është dorëzuar Plani Strategjik, duke u udhëzuar në mënyrë specifike për obligimet dhe detyrat që rrjedhin nga ky plan strategjik për secilin gjyqtarë dhe për gjykatën si institucion.

Gjatë vitit 2025, udhëheqësit e departamenteve do ti raportojnë Kryetares së gjykatës për punën e departamenteve që drejtojnë së paku njëherë në 3 (tre) muaj. Pjesë e raporteve duhet të jenë obligimet dhe detyrat që dalin nga Plani Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi.

Bashkëpunimi në mes të Divizioneve dhe Departamenteve me Udhëheqësit e Institucioneve, komunikimi i rregullt si dhe raportimi në baza të rregullta, janë planifikimet dhe synimet për vitin 2025, me qëllim të realizimit të plotë të Planit për Përmasimin e Qasjes në Drejtësi.

Shpërndarja e barabartë, dhe caktimi i bashkëpunëtorëve profesional për secilin Gjyqtar, është një hap që synojmë të rrisim efikasitetin në zgjidhjen e lëndëve duke shkurtuar sa më shumë kohën që kërkohet për zgjidhjen e rasteve.

Trajtimi i lëndëve më të vjetra se 24 (njëzetë e katër) muaj do të jetë prioritet dhe do ti kushtohet vëmendje e veçantë. Edhe në raportin e Punës për vitin 2024, kemi paraqitur moshën e lëndëve në pritje, andaj për vitin 2025 kjo fushë do të jetë në monitorim të veçantë, në mënyrë që të arrihen rezultate më të mira sa i përket lëndëve në pritje më të vjetra se 12 (dymbëdhjetë) muaj. Edhe në raportet tre mujore do të raportojmë në baza të rregullta për moshën e lëndëve në pritje.

Në planin e punës për vitin 2025, vazhdojnë punën 2 (dy) gjyqtare me angazhimet specifike dhe të veçanta dhe atë: 1 (një) gjyqtar koordinator për monitorimin e rasteve të dhunës në familje në divizionin penal dhe pas fillimit të punës së tre gjyqtarëve të cilët janë në trajnim do të caktohet një gjyqtar i vetëm për trajtim të lëndëve të dhunës në familje. Në divizionin civil 1 (një) gjyqtar do të caktohet të punojë për trajtimin e rasteve të urdhër mbrojtjes, me qëllim të trajtimit në afat sa më të shpejtë të këtyre rasteve, që edhe gjatë vitit 2024 ka rezultuar me sukses.

Zbatimi i Strategjisë për Përmirësimin e Qasjes në drejtësi 2022-2025, si dhe planit të veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, do të jenë synimet dhe parimet kryesore të punës për trajtimin e lëndëve gjatë vitit 2025 në të gjitha departamentet dhe divizionet.

Të gjitha këto synimet dhe qëllimet për vitin 2025, do të monitorohen në mënyrë të rregullt, në baza 3 (tre) mujore, ashtu që secili Departament, Divizion dhe sektor i gjykatës

do të ketë përgjegjësin që do të raporton tek Kryetarja e gjykatës, e këto raporte do të përcillen edhe tek KGJK-ja dhe komisionet adekuate.

Tashmë është evidentuar dhe identifikuar grupi i lëndëve për tu trajtuar brenda vitit 2025, sipas udhëzimeve të Planeve Strategjike të KGJK-së dhe gjatë vitit 2025 synojmë të kemi raporte të sakta dhe të detajuara për gjendjen dhe ngarkesën me lëndë, duke iu referuar Planit për Efikasitet dhe Prioritetit.

Gjatë vitit 2025 kemi qëllim të monitorojmë trajtimin e lëndëve më të vjetra se 24 (njëzetë e katër) muaj, për secilin departament, numrin e lëndëve të kthyera në rigjykim, numrin e lëndëve që në 6 (gjashtë) muajt e ardhshëm arrijnë parashkrimin dhe atë për secilin gjyqtar.

Gjyqtarët, dhe udhëheqësit e departamenteve do të krijojnë raporte të veçanta tre mujore, për të paraqitur gjendjen e lëndëve që kanë në zyre dhe departament, duke specifikuar lëndët që rrezikojnë të parashkruhen, lëndët e krimit të organizuar të shënjestruara, lëndët e natyrës së korrupsionit zyrtar si dhe lëndët tjera të përcaktuara në strategji si prioritet. Gjithashtu, Divizioni Civil do të ketë në fokus të veçantë lëndët që janë në rigjykim, kontestet të natyrave sociale dhe kontestet e punës, si dhe lëndët tjera të përcaktuara në strategji si prioritete.

Zbatimi i plotë i legjislacionit për respektimin e gjuhëve zyrtare

Gjykata Themelore në Prizren dhe degët e saj, gjatë vitit 2025, do të kenë 4 (katër) përkthyes, 3 (tre) në Prizren (një e caktuar për Divizionin Civil), 1 (një) në Dragash, kurse për Suharekë përkthyesit e gjykatës angazhohen sipas kërkesave. Përkthyesit janë të angazhuar nëpër seanca dhe në përkthime të shkresave. Sipas organo gramit mungon një përkthyes për gjuhën shqip-gjuhë boshnjake dhe anasjelltas si dhe mungon një përkthyes për gjuhën shqip-gjuha turke dhe anasjelltas (është në proces).

Gjatë vitit 2025, me iniciativën për përkthimin e dokumenteve përmes sistemit elektronik, synohet që të shpërndahet në mënyrë të barabartë puna dhe ngarkesa për përkthyesit.

Të gjithë gjyqtarët dhe stafi administrativ do të udhëzohen që të zbatojnë 100%, programin elektronik dhe përkthimi i shkresave të dërgohet në formë elektronike.

Në Gjykatën Themelore Prizren dhe degët e saj është bërë shenjëzimi i hapësirës me gjuhët zyrtare dhe i gjithë stafi administrativ i gjykatës respekton gjuhët zyrtare dhe ka gatishmëri për përdorim të secilës gjuhë të cilën e përdor pala e cila vjen në gjykatë.

Zbatimi i akteve të KGJK-së lidhur me organizimin e brendshëm dhe menaxhimin e punës së gjykatave, performancës së gjykatave si dhe normën e punës së gjyqtarëve

Organizimi i punës, organizimi i brendshëm dhe menaxhimi i punës së gjykatë bazohet në planin e punës së KGJK-së, Rregulloren nr.02/2020 për organizimin dhe veprimtarinë e brendshme të gjykatave, si dhe akteve tjera të KGJK-së, ku parashihet se që organizimi i brendshëm të planifikohet nga ana e Kryetares së gjykatës dhe administratori (gjyqtari mbikëqyrës dhe ndihmës administratori) sipas specifikave të cilat i ka gjykata, respektivisht dega e gjykatës. Për vitin 2025 planifikohet që të përfundoj plotësimi i vendeve të punës, të cilët ende janë të pa plotësuar (administrator, zyrtar për shpenzime, bashkëpunëtorë profesional, dorëzues, zyrtar ekzekutiv, mbikëqyrësi i sektorit për ekzekutim dhe arkivim dhe statistika, përkthyes). Gjithashtu, planifikohet që gjatë viti 2025 të përfundoj procesi i transferimit të punëtorëve të cilët punojnë në një vend pune me titull dhe detyra pune të përcaktuar për atë vend pune. Sa i përket lëmisë civile planifikohet që të forcohet zyra e pranimit të lëndëve dhe zyra e shpërndarjes së lëndëve, duke pasur parasysh se kemi numër të lartë të lëndëve në lëmine civile në krahasim me lëmine penale dhe kjo na detyron që edhe planifikimi i punës të bëhet në bazë të numrit të lëndëve dhe kërkesave të palëve.

Sa i përket organizimit të punës së gjyqtarëve dhe normës të cilën duhet të arrijnë bazuar në raportet e zyrës së statistikave ku është konstatuar se gjyqtarët nga DKR-ja nuk ka arritur normën e përcaktuar me rregulloren për normën, duhet të bëhet planifikimi adekuat për plotësimin e lëndëve të gjyqtarëve nga ky departament me lëndë nga departamenti i përgjithshëm, në mënyrë që të njëjtit të arrijnë dhe të plotësojnë normën e përcaktuar. Në fillim të muajit janar të viti 2025 do të avancohet një gjyqtar nga Departamenti i Përgjithshëm Penal në Departamentin e Krimeve të Rënda pasi që sipas Kodit Penal të Ri nga muaji shkurt, gjyqtarët e DKR-së do të duhet të gjykojnë në kolegje prej tre gjyqtarëve nga ky departament dhe në rastin konkret janë 4 gjyqtarë në këtë departament (një gjyqtarë në muajin shkurt do të pensionohet) dhe nuk do të bëhet e mundur që të formohen kolegje përkatëse për DKR. Gjithashtu planifikohet që gjyqtari i cili do të avancohet në DKR do të bartet së bashku me lëndët të cilat i ka në punë nga Departamenti i përgjithshëm dhe këto lëndë do të ndahen edhe gjyqtarëve të tjerë në mënyrë të barabartë në këtë departament. Një planifikim tjetër do të jetë që do të caktohen edhe 2 gjyqtar me vendim në DKR të cilët do të kenë mundësi që të jenë pesë e trupit gjykues, por të cilët nuk do të pranojnë lëndë dhe të gjykojnë lëndët e kompetencës lëndore të Departamentit të Krimeve të Rënda. Gjithashtu planifikohet të bëhet transferim i një gjyqtari nga DKR në Gjakovë në DKR në Prizren në pjesën e tremujorit të dytë të vitit 2025.

Plani për Drejtësi Procedurale në Gjykata

Gjykata Themelore në Prizren, ka formuar grupin punues për implementimin e plotë të aktiviteteve që rrjedhin nga Plani për Drejtësi Procedurale në bashkëpunim me partnerët e USAID.

Aktivitetet që ka mbështetur USAID dhe që janë në zbatim së bashku me grupin punues në gjykatë përfshijnë:

Takimet e brendshme (të realizuara dhe në vazhdimësi sipas nevojës).

Grupin shfrytëzues të gjykatës

Sinjalizimi dhe shenjëzimi, (të realizuara në shkallën 90%)

Kartelat identifikuese (e realizuar 100%)

Ekspozimi i emrave dhe pozitave (e realizuar 100)

Rregullat e sjelljes, trajnimet për stafin administrativ (E realizuar, në vazhdimësi)

Kutia e komenteve (e realizuar 100%).

Përmirësimi i qasjes për persona me aftësi të kufizuara (E realizuar, në vazhdimësi).

Përmirësimi i qasjes në gjykatë dhe shërbime për qytetarët (E realizuar, në vazhdimësi).

Funksionalizimi i objektit të Gjykatës për Divizionin Civil (E realizuar 100%)

Ruajtja dhe arkivimi i lëndëve në gjykata

Gjykata në fillim të vitit 2025, do të ketë të angazhuar 2 (dy) zyrtarë të arkivës.

Gjykata do të ketë në 2 (dy) objekte të ndarë arkivin. Gjatë vitit 2025, do të evidentohen lëndët sipas kërkesës së KGJK-së, për identifikimin dhe arkivimin e lëndëve nga lëmia civile dhe penale, që janë më të vjetra dhe që plotësojnë kushtet për arkivim në Arkivin Shtetëror. Për të gjitha lëndët që do të arkivohen do të zbatohet procedura e paraparë sipas Rregullore për arkiva, do të mbahen regjistrat dhe do të bëhet arkivimi nëpërmjet sistemit SMIL.

Identifikimi i lëndëve, që plotësojnë kushtet për arkivim në Arkivin Shtetëror do të bëhet në TM1, kurse në TM2, TM3 dhe TM4, do të bëhet dorëzimi në Arkivin Shtetëror, duke pasur parasysh se kemi një numër të madh të lëndëve të cilat duhet të arkivohen dhe të dërgohen . Ky proces i implementimit do të kryhet përmes zyrës së arkivës, dhe zyrës për menaxhimin e lëndëve nën mbikëqyrjen e Administratorit të gjykatës.

Zbatimi i rekomandimeve që dalin nga raportet inspektuese nga njësia që monitorojnë punën e gjyqësorit

Udhëheqësit e zyrave, për vitin 2025 kanë dhënë propozimet për hartimin e regjistrave fizik dhe unifikimin e regjistrave. Këto propozimet kanë ardhur sipas njësisë e cila ka evidentuar regjistrat në gjykatë në vitin 2024.

Në fillim të vitit 2024 kemi pranuar raportin nga njësia për inspektim gjyqësorë lidhur me identifikimin e arsyeve për hedhjen e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë si “jo lëndore”, të lëndët e caktimit/vazhdimit të paraburgimit. Në bazë të këtij raporti ka rezultuar se duhet të veprkohet më shpejt në procedimin dhe vendosjen e lëndëve me paraburgim, të respektohen dispozitat ligjore të nenit 189 të KPP-së, të respektohet dispozita ligjore e nenit 38 (par. 2 pika 2.1) e RROBGJ-së, të respektohen dispozitat e Udhëzuesit për procedurën e dërgimit të shkresave nga gjykata dhe ka propozuar që aktvendimet për caktim/vazhdim të paraburgimit të dorëzohen/ekspedohen menjëherë pas marrjes së tyre i cili ekspedim do të bëhet përmes postës elektronike. Andaj, gjykata jonë duke u mbështetur në këtë raport bën ekspedinimin e vendimeve për caktim/vazhdim të paraburgimit edhe nëpërmjet postës elektronike me qëllim të evitimit të vonesa të mundshme, si dhe çdo ankesë apo kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj vendimeve të paraburgimit nga ana e referentëve trajtohet në afat ligjor dhe bëhet bartja e lëndës në gjykatën e shkallës më të lartë.

Zbatimi i udhëzuesit për politikë ndëshkimore me qëllim të krijimit të praktikës të shqiptimit të dënimeve brenda sistemit gjyqësor

Duke pasur parasysh se tani kemi Udhëzuesin e reviduar për politikën ndëshkimore të nxjerrë nga Gjykata Supreme dhe me qëllim të krijimit të praktikës së shqiptimit të dënimeve brenda sistemit gjyqësor sipas udhëzuesit, në mbledhjet e kolegjiemeve të mbajtura është dorëzuar udhëzuesi të gjyqtarët penalist ku është diskutuara që i njëjti duhet të zbatohet në bazë pikave të përcaktuara në këtë udhëzues. Në vitin 2025 do të ri shqyrtohet dhe do të kërkohet raport nga gjyqtarët se a janë duke zbatuar udhëzuesin si dhe do të caktohen takimet me Gjykatën Supreme në mënyrë që të diskutohet për mënyrën e zbatimit të udhëzuesit. Konsideroj se në këtë drejtim gjatë viti 2025 rol vendimtar do të luaj edhe Gjykata e Apelit e cila me vendimet e veta mund të kanalizoj dhe të përcaktoj politikën ndëshkimore bazuar në udhëzues. Gjithashtu, duke e ditur rolin dhe rëndësinë e prokurorisë do të mbahen takime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë, në mënyrë që të diskutohet në lidhje me zbatimin e udhëzuesit për politikë ndëshkimore.

Zbatimi i udhëzuesit për referimin rasteve në ndërmjetësim

Për vitin 2025, Gjykata Themelore në Prizren do të ketë të angazhuar 2 (dy) zyrtar (Bashkëpunëtor Profesional), për trajtimin e rasteve të referuara në ndërmjetësim nga 1 (një) gjyqtar në Prizren dhe 1 (një) në Suharekë të cilët edhe janë duke punuar me rastet të cilat janë referuar në ndërmjetësim

Gjyqtarët në kolegjieme të mbajtura inkurajohen që të dërgojnë lëndët në ndërmjetësim sipas Udhëzuesit për lëndët e përshtatshme për ndërmjetësim, duke respektuar kategoritë e lëndëve për ndërmjetësim të detyrueshëm dhe lëndët e përshtatshme për ndërmjetësim, Duhet marrë parasysh faktin se gjykata ka kapacitet e

duhura që numri i rasteve të zgjidhura përmes formave alternative/ndërmjetësimit, të jetë më i lartë dhe më efikas.

Zbatimi i udhëzuesit për shpërndarjen e shkresave duke evituar mundësinë e dështimit të seancave

Gjykata gjatë vitit 2025, do të zbaton në tërësi Udhëzuesin për procedurën e dërgimit të shkresave nga gjykata i dt.08.08.2022, që parashih format e ftesave dhe shkresave të tjera.

Të gjithë gjyqtarët dhe stafi administrativ, në mënyrë unike do të përcaktojnë procedurën dhe ndërmarrjen e veprimeve për dorëzimin/dërgimin e shkresave, tek palët në procedurë përmes dorëzuesit apo postës së rregullt.

Nga udhëheqësit e zyrave dhe mbikëqyrësit do të sigurohet që është duke u zhvilluar një procedurë e qartë lidhur me dorëzimin e shkresave përshtatshëmrisht me udhëzuesin në fuqi.

Procedura e shpërndarjes së shkresave është duke u zbatuar në bazë të udhëzuesit por kemi vonesa në dorëzim për shkak të numrit të vogël të dorëzuesve.

Monitorimi dhe Raportimi

Hartimi i planit për monitorimin e punës së gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve dhe administratës nga ana e Kryetarit të Gjykatës

Gjatë vitit 2025 do të hartohet plani për monitorim të punës së gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve dhe të administratës. Sa i përket Planit të monitorimit të punës së gjyqtarëve do të fokusohet në arritjen e rezultateve të realizimit të normës së punës në afate tremujore, në realizimin e dhe kryerjen e lëndëve me prioritet dhe lëndë të vjetra, në raportimin e seancave të mbajtura dhe të shtyera, ose të dështuara në baza tremujore dhe krahasimi i këtyre rezultateve. Gjithashtu do të vlerësohen rezultatet e raporteve të siguruar nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare si dhe që këto vlerësime të reflektojnë gjatë punës në afate sa më të shkurta.

Në lidhje me bashkëpunëtorët planifikohet që të njëjtit të raportojnë çdo muaj për punën e kryer dhe që kjo punë të vlerësohet me normën e përcaktuar nga Udhëzuesi për normën e bashkëpunëtorëve. Në çdo tre muaj do të bëhet vlerësimi i të arriturave dhe norma e realizuar, kurse në fund të viti do të vlerësohet norma vjetore e punës së të gjithë bashkëpunëtorëve.

Sa i përket administratës, monitorimi dhe vlerësimi i punës së administratës bëhet nga ana e Administratorit të gjykatës dhe në fund të vitit raportohet tek kryetarja për punën dhe ecurinë një vjeçare të administratës.

Hartimi i raporteve periodike dhe vjetore të punës së Kryetares së gjykatës, dhe gjyqtarëve mbikëqyrës të degëve të saj

Kryetarja e gjykatës, gjyqtarët mbikëqyrës, çdo 3 (tre) muaj gjatë vitit 2025, do të hartojnë raportin e rregullt, që përfshin pikat e rregullta për raportim dhe sipas kërkesës së KGJK-së, do të hartojnë raporte të veçanta.

Gjithashtu në muajin Janar, do të përpilohen raportet vjetore për vitin paraprak, të cilat do të paraqiten për aprovim nga KGJK-ja.

Për të dhënat statistikore të raporteve, do të përdoret platforma SMIL.

Gjyqtarët mbikëqyrës, sipas nevojës dhe kërkesës së Kryetares së gjykatës, hartojnë raporte të veçanta për aktivitet dhe organizimin e degës së gjykatës.

Synimet e Gjykatës në realizimin e objektivave që dalin nga plani i punës			
		Minimumi i caktuar nga KGJK	Synimi i caktuar nga Gjykata
I.	Reduktimi i lëndëve sipas planit strategjik per qasje ne drejtësi 2022-2025	20%	30%
II.	Reduktimi i lëndëve te vjetra	20%	30%
III.	Realizimi i normës se punës së gjyqtarëve	100%	100%
IV.	Realizimi i normës se punës së bashkëpunorëve profesional	100%	100%
V.	Ngritja e cilësisë se vendimmarrjes respektivisht zvogëlimi i numrit te lëndëve të kthjera në rigjykim	20%	30%

VI.	Rritja e numrit të vendimeve të publikuara	30%	50%
VII.	Rritja e numrit të seancave bllok në trajtimin e lëndëve	30%	40%
VIII.	Planifikimi i seancave dhe zvogëlimit të numrit të seancave të shtyra dhe të anuluar	20%	30%
IX.	Rritja e kualitetit të të dhënave në raport me regjistrimin e lëndëve e deri në përfundim të lëndëve duke harmonizuar dosjen elektronike me dosjen fizike me të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra	95%	100%
X.	Vendosja e drejtë e vendimeve gjyqësore në regjistrin e Evidencës Penale	100%	100%
XI.	Zbatimi i planit për drejtësi procedurale	100%	100%
XII.	Regjistrimi i plotë i të gjitha lëndëve në arkiv	100%	100%

Përfundimi

Si përfundim, presim që viti 2025 të jetë vit i suksesshëm si në aspektin e përfundimit të lëndëve, efikasitetit të gjyqtarëve, por edhe administratës në përgjithësi. Vonesat në trajtimin e lëndëve duhet ti takojnë të kaluarës, aplikimi i zgjidhjeve alternative të lëndëve si penale ashtu edhe ato civile - ndërmjetësimi, marrëveshja për pranimin e fajësisë, urdhrat ndëshkimor, racionalizimin e seancave tek rastet jo të komplikuar, aplikimi i seancave të njëpasnjëshme është e nevojshme që të avancohen në praktika përditshmërie të zgjidhjes së çështjeve gjyqësore.

Vëmendje e posaçme do të i kushtohet lëndëve që janë në rigjykim dhe lëndëve më të vjetra se 24 muaj, pasi pikërisht te këto lëndë ekzistojnë vonesa, që duhet sa më parë të eliminohen dhe çështjeve të i'u hapet rruga drejtë epilogut përfundimtar. Është synuar që gjykata të jetë aktive në procedimin e çështjeve duke e minimizuar kohën pasive të lëndës, ashtu që edhe këtë vit do të angazhohemi në kontrollin paraprak të padive në kohën sa më të shkurtë, në mënyrë që të identifikohen lëndët të cilat mund të përfundohen në këtë fazë apo edhe të eliminimit të mangësive në periudhën sa më të hershme të procedimit të tyre.

Prioritet i rëndësisë së veçantë do të ju jepet lëndëve të shënjestruara, krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ky plan dhe program mund të ndryshohet dhe plotësohet nga Kryetarja e gjykatëse varësisht nga nevojat për organizimin më efektiv të punëve, zgjidhjen më efikase të lëndëve dhe në rast të ndryshimit të numrit të gjyqtarëve dhe strukturës së gjykatës.

Ky plan i punës dhe programi për zgjidhjen efikase të lëndëve, zbatohet nga 1 janar 2025.

Dhjetor 2024

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prizren
Shpresa Emra

